

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-795/022	Data: Datum: 24.10.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe nenit 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 8 paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, dhe në nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2020 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën 02 Nr.57/2022 të datës 24.10.2022, të parashtruar nga Drejtoria për Administratë Komunale për anulimin e thirrjes publike të datës 04.10.2022 për projektin: "16 ditë e aktivizimit kundër dhunës në familje", për shkak të mos përzgjedhjes së dy anëtarëve të jashtëm, në cilësinë e ekspertëve në Komisionin Vlerësues, nxjerr:

V E N D I M

1.SHFUQIZOHET: Vendimi 01Nr.720/2022 i datës 29.09.2022 për shpalljen e thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve dhe programeve të OJQ-ve.

2. Anulohet thirrja publike e datë 04.10.2022 për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve dhe programeve të OJQ-ve. Drejtoria për Administratë Komunale për shkak të mos përzgjedhjes së dy anëtarëve të jashtëm, në cilësinë e ekspertëve në Komisionin Vlerësues, i ka rekomanduar Kryetarit për anulim.

3. Vendimi 01Nr.350/2022 i datës 25.05.2022, nuk është në fuqi nga data 24.10.2022.

4. Obligohet Drejtoria për Administratë Komunale që të **Rishpallë thirrjen publike me datën 25.10.2022.**

5. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për realizimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Administratë Komunale..

6. Vendimi është përfundimtarë.

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Administratë Komunale dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ


